

E DIEL

14 Korrik

2019

MILOSA O



Ekskluzive

IVICA BULJAN

Regjisori i famshëm kroat kritikë politikanëve të Ballkanit me 'Jul Qezarin'

NGA BEN ANDONI

Kur Shqipëria është e kapluar nga situata të pafundme krize politike, një regjisor kroat tenton të edukojë publikun me teatrin, por edhe të japë mesazhe të qarta për politikën. Tragjedia e njohur e Shekspirit "Jul Qezar" do jetë në skenë dhe do të synojë të përcjellë në kohët e reja përballjen me pushtetin. Teatri Eksperimental "Kujtim Spahivogll", i cili po bashkëpunon me regjisorin Ivica Buljan, i cili është mundësuar dhe falë producentit të njohur Pleurat Himaduma, ka bërë një zgjedhje që duhet vlerësuar jashtëzakonisht. Shpresa është të jetë në mesin e Korrikut dhe regjisori planifikon që shfaqja të realizohet në mjediset e jashtme të Teatrit Kombëtar: bazenit dhe sheshin para teatrit.

Regjisori kroat ka kohë që e ka kaluar synimin e tij për

njohje dhe sfida, kurse jeta e vet ndahet mes Kroacisë dhe Sllovenisë. Për ata që nuk e dinë, artistit Buljan është nga artistët më të njohur të kohës në teatër dhe pak kohë më parë është konsideruar si një nga 10 regjisorët më të mirë në botë, shpallur nga "New York Times".

E veçanta me këtë njeri nuk është thjesht aftësia profesionale, por mesazhet politike dhe filozofike që do të përcjellë me lëmin e vet. E quan veten një nxënës të Zhizhek, filozofit kontrovers ballkanik, por duket se formimi i tij mbart shumë nga kultura perëndimore. Dhe, që në

mënyrën sesi punon me aktorët ti arrin të kuptosh mesazhet që përcjell ky njeri, i cili pikë së pari misionin e kërkon nga ana e artistëve të tij.

Profesionist i përkorë, i sjellshëm, modest, i përqendruar, ai mund të kundrohët si një njeri fare i thjeshtë, por në fakt statura e tij mbart shumë. Jo thjesht se e ka shtuar gjeografinë artistike të Ballkanit, por është një individ që nuk di të ndalet. Dhe, një artist i tillë duhet të vlerësohet sepse peshën e madhe të artit e ndan si përgjegjësi të vetë tij, artistëve që

ai drejton dhe publikut që dëgjon. Në konceptin e Ivica Buljan, teatri është më shumë se edukim është një art sublim, paçka trendëve të sotme të kohës.

"Bota e sotme është e komplikuar, shumë më e komplikuar se sa në vitet tetëdhjetë, kur unë u formova, ose edhe në vitet e nëntëdhjeta, kur ra Perdja e Hekurt dhe u krijua një rend i ri evropian. Planeti Toka është bërë viktimë e kapitalizmit global. Të gjithë ne po luftojmë me problemet e ndotjes, ndryshimeve klimatike, frikën e konflikteve të luftës, duke

u kthyer drejt politikave nacionale dhe totalitare, të cilat e shpallin lirinë. Nga ana tjetër, bota është globale, dhe është shumë e lehtë për të marrë informacion, e për t'u takuar njerëz. Procesi i progresit ka qenë i ngadalshëm në Ballkan gjatë shekujve. Demokracitë që po përpigemi t'i krijojmë me shumë vështirësi, kanë një traditë të ndryshme në Ballkan krahasuar me atë që bëhet në Evropën Veriore. Atje teatri është pjesë e jetës shoqërore, e fokusuar në elitën. Te ne, teatri ngjan me realitetin show që zhvillohet në Parlament, në Qeveri, në media. Ka raste të shumta korrupsioni, abuzimi, e politikanët që sillen si komedianë të këqij", citohet ai për "Milosao".

→ Vijn nga faqja 14

**Në këtë numër: IVICA BULJAN, ARIAN LEKA, QERIM VRIONI, ALBAN GJATA, NDREK GJINI SJELL
POETËT KLASIKË TË IRLANDËS ETJ...**

L

LETËRSIA

Bashkëpunëtori jonë i "Milosao" na ka sjellë një cikël me autorët klasikë të Irlandës, por edhe ata që kanë bërë historinë e letërsisë në këtë vend dhe më shumë akoma...



1. Samuel Becket

Do doja që dashuria ime të vdese
Do doja që dashuria ime të vdese
Dhe shi të bjere mbi varreza
Dhe mbi mua tek ec rrugeve
Duke mbajtur zi për ate që me dashuronte.

2. Geoffrey Squires

Sa mire të kisha një shepi të qete
Sa mire të kisha një shtëpi të qete
Timen perseri. Ku të kisha mundesi të ec
Drejt një dhome, ku e di që aty jam vec une
Ku asgjë s'leviz përvec meje.
Ku s'ndehet asnjë zhurmë përvec zhurmes
që une bej.

3. Cathal Searcaigh

Kthimi i kurbetliut
Ai është kthyer sonte tek shtëpia e brakti-
sur.
Pranë portes së hyrjes nën shkeqimin e
henes
Një hije e ngrirë; pema që ai mbolli shumë
vite më parë,
Tani, gati trung i kalbur.

4. Andrew Elliot

Sot...
Shekuj me radhe burrat bene dashuri
Duke lene hijen e tyre të rende mbi grate.

Sot une deshiroj që hija ime të ngjaje
Një zogu që fluturon mbi lumin që rrjedh.

5. John Hewitt

Kaltersi dhe bardhesi
Deti i kalter, i kalter qielli
Te dy të shndritshem jane.
Puleardhat si dallge deti;
Dallget si pilebardha ngajne.

6. Paul Durcan

Ireland 1972
Ngjitur me varrin e ri gjyshes që e desha aq
shume
Varri së dashures sime, vrare prej tim vel-
lai.

7. Dermot Healy

Zjarri
Në se e lini zjarrin fikur.
Shpirti endet përmes fushes
Si flake që digjet
Dhe shuhet në vater tjetër.

Oh, shpirt i pafat
I ndare prej meje
Brenda shtëpise sime të ftohte.

8. Seamus Heaney

Një nate gushti
Duart e tij ishin të ngrohta, të vogla dhe të
njuhura për mua.
Kur i pashe serish mbreme ato më ngjane, si
dy nuselale.
Duke luajtur të vetmuara me njëra-tjetren,
në fushen e pruar me hene.

9. W.B. Yeats

Kenge pijanecesh
Vera hyn në gojë
Dashuria vjen në sy.

Kjo është krejt ajo ç'ka në duhet të dime
Para se të plakemi dhe vdesim.

Une ngre goten tek goja
Shoh nga ju dhe vec psheretij.

10. Michael Foley

Forca e fjalës për të shpërhur ndjenjat
Kur e dashura iku dhe e la, ai s'mundi të
fliste dot ansje fjale.
Dhe kur ajo u kthye serish tek ai, e lumtur
si më parë.
Krisht, ajo ishte. Krisht! Oh Krisht!
E bekuara e tij, ardhë në emer të Zotit.

11. Tony Curtis

Qetesi
Në qetesine e neteve degjoj
Kenget që gjyshja ime kondon.
Tri kenge trishtimi për shtëpine.

12. Patrick Kavanagh

Shenjterim
Te jesh poet dhe të mos dish sa libra të janë
shitur
Te jesh dashnor i mire dhe të rrih larg
femrave.
Dy paradokse që i krijuan të medhenjtë
shenjter.
Duke dhene shpirt mes dhembëve të parajs-
es.

13. Richard Murphy

Kenge djepi
Para se ti të provosh t'i vesh një emer vde-
kjes
përshembull ari ose krokodil, ajo ka ardhur
në nate për të marrë me vete nënende
Por kur ajo desh të thoshte të fundit "naten

e mire",
ti qave, "nuk dua që ti të ikesh" i the,
keshuqe, ajo të mori në krah të saj edhe
ty.

14. James Simmons

Poezia e një ditelindje
Për cdo vit të jetes në ndezim
Nga një qiri në torten e ditelindjes
thjeshtë për të shenuar arritjet
që cdo njeri mund të ketë bere.
Dhe më pas kur thuhet urimet
Dhe hapen dhuratat,
shfaqet menjehere vizioni i vdekjes
Kur të thone të fikesh qirinjtë e secilit vit
Vetem me një frymë.

15. Padraig Daly

Fund viti
Tufat e zogjve kthehen në cerdhet e tyre mbi
peme
Lumi vrapon në rrugën e tij të argjente
Malet nisin të rrezohen në erresire.

Shume shpejt vetem qielli do të mbetet real
dhe shtëpите e zvogeluara si një lyster me var-
ak.
rreth e rreth kodres.

16. Medbh McGuckian

Tymi
Ato vendosen shkurre në zjarrin në qosh të
rruges
Une u friksova pa mase pasi mendoja me
vete
se era shume shpejt mund ta nxjerre jashtë
kontrollit
ate gjarpër të verdhë në levizje, tek ajo kod-
er larg shtëpive.
Por ato dukeshin shume të sigurte në ate që
benin
Ndersa une krejt i pazoti të permbaje veten.
Ika më vrap derisa pashe se kerpurdha e
tymit u shpernda.

17. Geoffrey Squires

Cdo gjethe është e lagur
Cdo gjethe është e lagur

Dhe dhelpra vrapon në rrugën e saj

Planete të vogla shiu
Mbi barin e kositur
'Tunden prej një merimange tek end e qete.

18. Sean Dunne

Leter në Lisbonë
Dikur, në një restorant të pata pastruar
një therrime buke prej fundit tend.
Ç'mashtrim që paten bere duart e mia ate
cast!
Pasi une s'doja të të pastroj ate therrime
Por të të prek pak kofshen tende.

19. William Pskett

Lindje dhe vdekje
Lindje dhe vdekje
Ekzaktesisht ju jeni
si dy miq të vjetër
që shtyni me force njerzit e turmes
pasi deshironi të takoheni sa më parë.

Si dy shtare besnik të diktatorit mbret
Ju jeni duke m'i kanosur egersisht
Ndjenjat dhe ambicjet e jetes

Dhe duke ma mbushur koken
Vec me vetveten time.

20. Julie O'Callaghan

Mungese letre
Mos u justifiko duke me thene
se e ke patur shume të veshitire
te gesh një flete letre të bukur, kineze
nga ato me ngjyre të kuqe.

Me shkruaj
qofte edhe mbi një rrase guri të bardhe
ose kerceilin e një mullage perdor
për të gdhendur fjalet e tua
mbi petalet e kuqe të një lululoti.

**PERKTHEU nga origjinali:
NDREK GJINI**